

Përmbledhje

Sistemi financiar u karakterizua me përforsim të performancës në të gjithë sektorët përbërës të tij në vitin 2017. Sektori bankar dhe ai pensional vazhduan të kenë kontributin kryesor në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit. Sektori bankar është karakterizuar me rritje të aktivitetit kreditues dhe nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit. Në TM4 2017, asetet e sektorit bankar u zgjeruan për 66.1 milionë euro, kryesisht rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues që u mbështet nga oferta e lehtësuar kreditore nga ana e bankave. Sektorët ekonomik që u kredituan më shumë në këtë periudhë ishin tregtia dhe ndërtimtaria, përderisa në kuadër të ekonomive familjare, kreditë për qëllime konsumi shënuan rritje më të theksuar.

Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në TM4 2017 u rritën për 45.6 milionë euro.

Në TM4 2017, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Norma e interesit në kredi në TM4 2017 qëndroi në nivel prej 6.8 përqind, kurse në depozita në 1.1 përqind.

Sektori bankar u karakterizua me performancë të kënaqshme financiare gjatë TM4 2017, duke realizuar fitim neto prej 16.2 milionë euro. Në këtë periudhë, sektori bankar shënoi rritje të të hyrave të gjeneruara, që kryesisht reflekton rritjen e të hyrave nga jo-interesi. Gjithsej shpenzimet gjatë kësaj periudhe shënuan rritje si rezultat i shpenzimeve të përgjithshme dhe atyre administrative.

Sektori bankar shënoi përmirësim të indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Në fund të vitit 2017, niveli i kredive jo performuese qëndroi në nivel prej 3.1 përqind kurse mbulueshmëria e tyre me provizione në nivel prej 150.5 përqind.

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në nivel prej 18.0 përqind (12.0 përqind – niveli i kërkuar nga BQK-ja) si dhe nivel të kënaqshëm të likuiditetit prej 38.2 përqind (25.0 përqind – niveli i kërkuar nga BQK-ja).

Me rritje të aktivitetit dhe përmirësim të performancës u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar.

Sektori pensional pati rritje të asetëve e që u reflektua edhe në rritje të peshës në asetet e sistemit financiar. Në tremujorin e katërt, ky sektor u karakterizua me ecuri pozitive të kontributeve të reja dhe kthim të konsiderueshëm bruto në investime.

Sektori i sigurimeve gjithashtu përmirësoi dukshëm aktivitetin dhe performancën gjatë këtij tremujori i cili u karakterizua me rezultat pozitiv financiar. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në përmirësimin e gjendjes së sektorit të sigurimeve ishin rritja në të hyrat neto nga primet, rënia e dëmeve të ndodhura dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve të sektorit.

Sektori mikrofinanciar ka vazhduar të rrisë aktivitetin, përderisa edhe tremujori i katërt u karakterizua me rritje të theksuar të asetëve si rezultat i rritjes së konsiderueshme të kredive të këtij sektori. Njëkohësisht, dinamikat në këtë sektor dhe rritja e konsiderueshme e të hyrave mundësuan dyfishim të profitit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017.

Tregu i letrave me vlerë u karakterizua me emetim më të lartë të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, rritje të afatit mesatar të maturimit, kërkesë më të lartë për të investuar në letra me vlerë, si dhe normë të përgjithshme mesatare të interesit më të lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE-----i

Sistemi Financiar -----	04
Sektori Bankar -----	04
Sektori Pensional-----	13
Sektori i Sigurimeve -----	14
Sektori Mikrofinanciar -----	16
Tregu i Letrave me Vlerë -----	19

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës -----	04
Figura 2. Ndryshimi tremujor i asetëve të sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	04
Figura 3. Ndryshimi tremujor në strukturën e asetëve të sektorit bankar -----	04
Figura 4. Ndryshimi tremujor në kredi dhe depozita në sektorin bankar -----	05
Figura 5. Ndryshimi tremujor në strukturën e kredive në sektorin bankar -----	06
Figura 6. Ndryshimi tremujor në strukturën e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	06
Figura 7. Ndryshimi tremujor në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	07
Figura 8. Struktura e depozitave-----	07
Figura 9. Ndryshimi tremujor në strukturën e depozitave-----	07
Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita -----	08
Figura 11. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	08
Figura 12. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	09
Figura 13. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare -----	09
Figura 14. Norma e interesit në depozitat -----	09
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	10
Figura 16. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	10
Figura 17. Profiti neto i sektorit bankar -----	10
Figura 18. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	11
Figura 19. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	12
Figura 20. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	12
Figura 21. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	12
Figura 22. Asetet e sektorit pensional -----	13
Figura 23. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	13
Figura 24. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	13

Figura 25. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së-----	14
Figura 26. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	14
Figura 27. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	15
Figura 28. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	16
Figura 29. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	17
Figura 30. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik-----	17
Figura 31. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	17
Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	18
Figura 33. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	18
Figura 34. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 35. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	19
Figura 36. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	19
Figura 37. Shuma e borxhit të emetuar -----	19
Figura 38. Shuma e kërkuar dhe e emetuar -----	20
Figura 39. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	20
Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës -----	20
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	24


SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Sistemi Financiar

Zgjerimi i asetëve të sistemit financiar vazhdon të jetë rezultat i rritjes të sektorit bankar dhe atij pensional. Sektorët tjerë vazhdojnë të kenë kontribut të ulët në zgjerimin e asetëve të sistemit financiar.


Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Në fund të TM4 2017, vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.92 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 9.9 përqind (figura 1).

Figura 2. Ndryshimi tremujor i asetëve të sektorëve përbërës të sistemit financiar



Burimi: BQK (2018)

Edhe në figurën 2 mund të vërehet që sektori bankar dhe ai pensional vazhdojnë të kenë kontributin

kryesor në rritjen e asetëve të sektorëve përbërës së sistemit financiar në baza tremujore.


Sektori Bankar

Sektori bankar vijon të karakterizohet me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues, performancë të mirë financiare dhe nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit.

Asetet

Asetet e sektorit bankar në TM4 2017 u zgjeruan për 66.1 milionë euro, duke arritur vlerën prej 3.88 miliardë euro. Kontributin kryesor në zgjerimin e asetëve të sektorit bankar, për të dytin vit me radhë vazhdon ta ketë aktiviteti kreditues. Investimet në letrat me vlerë kishin kontributin e dytë më të rëndësishëm në rritjen e gjithsej asetëve të sektorit në TM4 2017.

Figura 3. Ndryshimi tremujor në strukturën e asetëve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)

Kurse, kategoria e bilancit me bankat komerciale ishte e vetmja kategori që shënoi rënie në këtë tremujor (figura 3), ndikuar kryesisht nga normat

negative të interesit të aplikuara në depozita nga bankat jashtë vendit (rreth 96.2 përqind e kësaj kategorie është e investuar në bankat jashtë vendit).


Në TM4 2017, stoku i *letrave me vlerë* të sektorit bankar u rrit për 18.7 milionë euro (rritje prej 30.9 milionë euro në TM4 2016) dhe arriti në 486.7 milionë euro. Ngadalësimi i rritjes së investimeve në *letrat me vlerë* reflekton trendin e përgjithshëm të ngadalësimit të aseteve të sektorit bankar në TM4 2017 krahasuar me TM4 2016. Për më tepër, ngadalësimi i rritjes së investimeve në letra me vlerë i atribuohet edhe fokusimit të investimeve të bankave drejt *aktivitetit kreditues*, si instrument më *profitabil*. Normat e ulëta të kthimit në letra me vlerë mund të kenë rezultuar në zhvendosjen e fokusit të bankave prej investimeve në tregun e *letrave me vlerë* drejt *aktivitetit kreditues*. Për më tepër, likuiditeti në sektorin bankar është në nivel të kënaqshëm, dhe mund të kenë ndikuar në interesim më të lartë të bankave në kreditim.

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes në 2.2 milionë euro në TM4 2017 (nga rritja prej 38.4 milionë euro në TM4 2016), duke shënuar vlerën prej 499.3 milionë euro. Ngadalësimi i rritjes së kësaj kategorie kryesisht i atribuohet zhvillimeve në kategorinë e bilancit me BQK-në, konkretisht *depozitave* të sektorit bankar, të cilat gjatë tremujorit aktual shënuan ngadalësim të theksuar vjetor. Për më tepër, aplikimi i normave negative të interesit (prej -0.40 përqind) për rezervat e bankave mbi nivelin e detyrueshëm prej 10.0 përqind, që nga fundi i TM2 2016, mund të ketë ndikuar nivelin e rezervave të mbajtura në BQK.

Kreditë

Kreditë e lëshuara nga sektori bankar përsheptuan rritjen përgjatë tërë vitit 2017, një rritje që karakterizoi edhe tremujorin e fundit të vitit 2017. Sektori bankar kreditoi ekonominë vendore në vlerë rekorde prej 78.2 milionë euro në TM4 2017, dukshëm më e lartë se vlera prej 45.6 milionë e shënuar në TM4 2016, dhe arritën vlerën prej 2.49 miliardë euro (figura 4). Ndikim në rritjen e *kredive aktive* kishin *kreditë e reja* të lëshuara si për *ndërmarrjet* (të cilat u rritën për 65.9 milionë euro në baza vjetore në TM4 2017 dhe arritën vlerën prej 218.3 milionë euro) dhe *ekonomitë familjare* (të cilat u rritën për 46.0 milionë euro në TM4 2017 dhe arritën në 143.9 milionë euro). Zhvillimet në stokun e *kredive aktive* dhe *atyre të reja*, ndër tjerash u ndikuan nga oferta lehtësuese e aplikuar nga bankat përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë ekonomike.


Figura 4. Ndryshimi tremujor në kredi dhe depozit në sektorin bankar



Burimi: BQK (2018)

Kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM4 2017 u rritën për 55.2 milionë euro dhe arritën vlerën prej 1.58 miliardë euro (figura 5).

Figura 5. Ndryshimi tremujor në strukturën e kredive të sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)


Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i tregtisë dhe ai i ndërtimitarisë shënuan rritjen më të lartë vjetore në TM4 2017. Kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej kredive të ndërmarrjeve, u karakterizuan me rritje më të ngadalëshme vjetore prej 30.0 milionë euro në periudhën raportuese (rritje prej 50.0 milionë euro në TM4 2016) dhe shënuan vlerën prej 785.8 milionë euro. Në anën tjetër, kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë përshpejtoi rritjen, ku në TM4 2017 kreditë e distinuara për këtë sektor u rritën për 11.2 milionë euro dhe arritën në 136.4 milionë euro.,.

Gjatë kësaj periudhe, kreditë ndaj sektorit të bujqësisë, prodhimitarisë si dhe shërbimeve tjera shënuan rritje, por që ishin dukshëm më të ulëta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM4 2017 u rritën për 22.9 milionë euro dhe arritën vlerën prej 897.6 milionë euro. Kjo rritje ndër tjerash reflekton ecurinë në kredite e reja të lëshuara nga bankat gjatë kësaj periudhe. Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe, kredite e reja të destinuara për konsum shënuan rritje

prej 106.0 milionë euro, apo 38.0 milionë euro më shumë se sa vlera në TM4 2016.

Figura 6. Ndryshimi tremujor në strukturën e kredive sipas veprimtarisë ekonomike




Burimi: BQK (2018)

Kurse, kreditë e reja hipotekare shënuan rritje prej 24.5 milionë euro gjatë këtij tremujori, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, tregon për një rritje për 5.6 milionë euro. Vlera e kredive të lëshuara për qëllime konsumi në tremujorin e fundit të vitit 2017 arriti në 369.5 milionë euro, përderisa kreditë e reja hipotekare arritën vlerën prej 91.2 milionë euro.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat në TM4 2017 u karakterizuan me ngadalësim të rritjes krahasuar me ecurinë e tyre në TM4 2016. Kategoria e dytë më e rëndësishme, ajo e burimeve vetanake, kryesisht si rezultat i rritjes së fitimit të realizuar, shënoi rritje prej 1.2 milionë euro krahasuar me TM4 2016 dhe arriti në 15.0 milionë euro. Kategoritë tjera nuk pësuan ndryshime të dukshme në kuadër të strukturës së gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake në TM4 2017 (figura 7).

Figura 7. Ndryshimi tremujor në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Burimi: BQK (2018)

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u rritën për 45.6 milionë euro në TM4 2017 kundrejt rritjes së shënuar në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak prej 108.4 milionë euro, dhe shënuan vlerën prej 3.09 miliardë euro. Rritja më e ngadalshme në kuadër të depozitave kryesisht reflekton zhvillimet në kuadër të depozitave për ndërmarrjet, të cilat u zvogëluan për 63.7 milionë euro dhe zbritën në 3.9 milionë euro në TM4 2017.

Figura 8. Struktura e depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2018)

2016, dhe shënuan vlerën prej 28.5 milionë euro në TM4 2017 (figura 8).

Këto zhvillime në kuadër të depozitave për ndërmarrje dhe veçanërisht depozitave për ekonomive familjare reflektojnë ndër tjerash normat e ulëta të interesit të aplikuara nga bankat në depozita.

Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 42.8 milionë euro në TM4 2017, krahasuar me rritjen për 60.3 milionë euro në TM4 2016. Depozitat e afatizuara, të cilat janë më sensitive ndaj normave të interesit, duke marr parasysh normat e ulëta të aplikuara nga bankat, u tkurrën për 39.7 milionë euro krahasuar me TM4 2016, duke qëndruar në vlerë prej 6.6 milionë euro në tremujorin e fundit të vitit 2017. Kurse, depozitat e kursimit, që janë kategoria me peshën më të vogël në kuadër të depozitave, ishte e vetmja kategori që gjatë TM4 2017 shënoi rënie, duke u zvogëluar për 3.7 milionë euro gjatë këtij tremujori (figura 9).

Figura 9. Ndryshimi tremujor në strukturën e depozitave




Burimi: BQK (2018)

Po ashtu, edhe depozitat për ekonomitë familjare u zvogëluan për 47.8 milionë euro në krahasim me TM4

Normat e Interesit¹

Në TM4 2017, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Dallimi në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 5.7 pikë përqindje (6.2 pikë përqindje në TM4 2016).

Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2018)

Norma e interesit në kredi në TM4 2017 u zvogëlua në 6.8 përqind përderisa norma e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.1 përqind kundrejt TM4 2016 (figura 10).


Normat e interesit në kredi

Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në zbriti në 6.4 përqind, nga 6.9 përqind sa ishte në TM4 2016 (figura 11).

Të gjitha kategoritë e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM4 2017 u karakterizuan me rënie vjetore. Rënia më e madhe (0.7 pikë përqindje) u shënuar tek kreditë me qëllime investuese, duke

zbritur në 6.5 përqind. Në periudhën raportuese, normat e interesit në kreditë me qëllime *jo investuese* bartën normë të interesit prej 6.2 përqind. Kategoritë tjera të normave të interesit të aplikuar ndaj ndërmarrjet siç janë *mbitërheqjet* dhe *linjat kreditore* bartën normat të ngjashme të interesit me vitin paraprak. Normat e interesit në kreditë me *kushte favorizuese*, të cilat mbulohen me para të gatshme dhe asete të ngjashme, vazhdojnë të bartin normë mjaftë të ulët të interesit (2.5 përqind në TM4 2017).

Figura 11. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj të gjithë sektorëve ekonomik vazhduan të shënojnë rënie, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin 2014 dhe 2015. Në TM4 2017, normën më të ulët të interesit në kredi shënoi *sektori i industrisë*, si rezultat i rënies më të theksuar të normave gjatë vitit 2017. Normat e interesit në kreditë ndaj *sektorit të bujqësisë* vijnë të jenë më të lartat, por nëse shikohen trendi i viteve të fundit, kemi një zvogëlim të theksuar të tyre deri në TM4 2017. Norma e interesit në kreditë ndaj *sektorit të industrisë, shërbimeve dhe sektorëve tjerë* ishin dukshëm më të favorshme krahasuar me ato ndaj *sektorit të bujqësisë*. Fillimi i implementimit të FKGK-

¹ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

së² dhe garantimi i kredive për këtë sektor mund të ketë inkurajuar bankat që të ulin normat e interesit në kredi ndaj agrobizneseve (figura 12).


Figura 12. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare ndoqën trendin e përgjithshëm të normave të interesit të aplikuara nga bankat.

Figura 13. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2018)


Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme për shkak që kreditë e destinuar për këtë kategori të ekonomive familjare janë të siguruara me patundshmëri. Në

TM4 2017, norma e interesit e aplikuar për kreditë konsumuese qëndroi në 5.9 përqind, një rënie prej 0.3 pikë përqindje krahasuar me TM4 2016. Normat e interesit të aplikuara për kredit konsumuese janë dukshëm më të larta dhe qëndrojnë mesatarisht në 7.8 përqind, megjithëse janë karakterizuar me rënie vjetore prej 0.3 pikë përqindje. Pavarësisht rënies së përgjithshme të normave të interesit si në kreditë ndaj ekonomive familjare ashtu edhe në kreditë për ndërmarrjet, bankat vazhdojnë të aplikojnë norma të larta të interesit për kategorinë e mbitërheqjeve. Kjo kategori në TM4 2017 kishte normë të interesit prej 14.8 përqind, që përbën edhe një rritje vjetore prej 2.6 pikë përqindje (figura 13).

Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita, pavarësisht rritjes së lehtë në vitin e fundit, vazhdojnë të jenë në nivele mjaftë të ulëta krahasuar me periudhat para vitit 2014 (figura 14). Normat e interesit në depozita për ndërmarrje vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare.

Figura 14. Norma e interesit në depozita




Burimi: BQK (2018)

² Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit qëndroi në nivel prej 1.6 përqind në TM4 2017, një rritje për 0.1 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e katërt të vitit paraprak. Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e kursimit (0.4 përqind në TM4 2017 nga 0.2 përqind në TM4 2016). Normat e interesit në *depozitat e afatizuara* për ndërmarrje shënuan ngritje të lehtë kurse ato të *transferueshme* mbetën në nivele të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 15)

Figura 15. Norma e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare vazhduan të jenë në nivel mjaftë të ulët (1.0 përqind në TM4 2017) krahasuar me periudhën para vitit 2014 (rreth 3.5 përqind). Normat e aplikuara në depozitat e ekonomive familjare në secilin tremujor të vitit 2017 janë të përafërta me tremujorët e tri viteve paraprake (figura 16).

Pra, norma e interesit në depozitat e transferueshme (0.002 përqind), të kursimit (0.2 përqind) dhe ato të afatizuara (1.0 përqind) në TM4 2017 janë të ngjashme me normat e aplikuara në TM4 2016, dhe pothuajse të pandryshueshme nga tre vitet e fundit.

Figura 16. Norma e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit bankar

Performanca financiare e sektorit bankar në TM4 2017 ishte e dyta më e mira gjatë një tremujori që nga fillimi i operimit të sektorit bankar në Kosovës. Kjo performancë e mirë financiare, krahasuar me TM4 2016, ishte rezultat i gjenerimit më të lartë të të hyrave dhe ngadalësimit të theksuar të shpenzimeve.

Vlera e profitit të realizuar në TM4 2017 arriti në 16.2 milionë euro, për 1.9 milionë më shumë krahasuar me tremujorin e katërt të vitit paraprak (figura 17).

Figura 17. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Gjatë periudhës TM4 2013 - TM4 2016, të hyrat e sektorit bankar kishin shënuar rënie të vazhdueshme, por për herë të parë në pesë vitet e fundit, të hyrat ndërprejnë këtë trend rënës. Pra, në TM4 2017, vlera e të hyrave arriti në 59.6 milionë euro, që paraqet një rritje për 3.7 milionë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 18). Rritja e të hyrave gjatë kësaj periudhe i atribuohet kryesisht rritjes së të hyrave nga jo-interesi, më saktësisht të hyrave nga tarifat dhe komisionet. Të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 75.2 përqind të gjithsej të hyrave, pas katër viteve të rënies së vazhdueshme, kanë shënuar rritje për herë të parë, që mund të jenë ndikuar nga rritja e përshpejtuar e aktivitetit kreditues, pavarësisht rënies së vazhdueshme të normave të interesit në kredi.


Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar gjatë TM4 2017 arriti në 43.4 milionë euro, rritje për 1.8 milionë krahasuar me tremujorin e fundit të vitit paraprak (figura 18).

gjatë këtij tremujori, krahasuar me TM4 2016. Shpenzimet për jo interesi, ishin kategoria e cila shënoi rënien më të lartë vjetore gjatë TM4 2017, si rezultat i ndarjes më të ulët të provizioneve për humbjet e mundshme në kreditë. Kjo nënkategori u zvogëluar për 4.5 milionë euro krahasuar me TM4 2016, në 3.1 milionë euro. Kjo rënie kryesisht është rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor, ndarje më të ulët të provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë. Shpenzimet e interesit në TM4 2017 ishin në nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo është si rezultat i normave të interesit në depozita, të cilat nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të madh me periudhën paraprake.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar u përmirësua, duke rënë në 72.8 përqind në TM4 2017 nga 74.5 sa ishte në tremujorin paraprak. Kjo erdhi si rezultat i rritjes së të hyrave dhe menaxhimit më të mirë të shpenzimeve nga bankat komerciale në vend (figura 18).

Performanca më e mirë financiare e sektorit bankar në këtë tremujor krahasuar me TM4 2016, rezultoi në përmirësim të dy indikatorëve të profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) edhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK). KMA u përmirësua në 2.1 përqind, konkretisht KMK në 16.7 përqind në TM4 2017 (figura 19).


Figura 18. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)

Kontribuuesit kryesor në rritjen e gjithsej shpenzimeve e kishin ato të përgjithshme dhe administrative, të cilat u rritën për 1.3 milionë euro

Figura 19. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Shënim: Në kalkulim të KMA dhe KMK profitti për tremujorin përkatës është anualizuar
Burimi: BQK (2018)

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar po vazhdon të karakterizohet me rënie të vazhdueshme të *kredive joperformuese* në vitet e fundit si dhe përmirësim të *mbulueshmërisë së tyre me provizione*. Niveli i *kredive joperformuese*, në fund të TM4 2017 qëndroi në nivel prej 3.1 përqind, që paraqet një rënie prej 1.8 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 20).

Figura 20. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Niveli i *mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione* u përmirësua edhe më tej duke i mbuluar rreth 50 përqind më shumë se sa niveli i kërkuar me rregullore, kryesisht si pasojë e rënies së theksuar të

vlerës së *kredive joperformuese* deri në fund të TM4 2017.

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar përmirësim të lehtë në fund të TM4 2017 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky tregues ishte për 0.2 pikë përqindje më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo ishte rezultat i rritjes më të lartë vjetore të kapitalit krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të aseteve të peshuara me rrezik.

Figura 21. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)


Treguesi kyç i likuiditetit, *raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra*, shënoi rënie në fund të TM4 2017 krahasuar me TM4 2016. Kjo rënie është ndikuar nga zhvillimet në aktivitetin kreditues të bankare, gjegjësisht rritjes së kredive (tkurrje të aseteve likuide në dispozicion nga bankat) si dhe zhvendosja së depozitave në kategorinë e transferueshme (rritjes së detyrimeve afatshkurtra) (figura 21).

Sektori pensional

Ecuria pozitive e kontributeve të reja dhe kthimit bruto në investimet e aseteve nga ana e fondeve ndikuan që ky sektor të rritet gradualisht ndër vite.

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 27.9 përqind të gjithsej aseteve.


Figura 22. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK (2018)


Asetet e menaxhuara nga ky sektor vazhduan të rriten edhe gjatë TM4 2017. Asetet e fondeve pensionale janë për 30.1 milionë euro më të larta kundrejt TM4 2016 (figura 22).

Figura 23. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM4 2017)



Burimi: FKPK (2018)

Figura 24. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM4 2017)



Burimi: FSKP (2018)

Kjo rritje u ndikua nga investimi më i madh i aseteve jashtë vendit, komponentë që përbën pjesën më të madhe të aseteve të fondeve. Më saktësisht, FKPK si përfaqësuese e rreth 99.5 përqind të gjithsej aseteve të fondit pensional, shënoi rritje të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në nivelin prej 20.8 përqind, ndërsa investimi në fondet e përbashkëta investive jashtë vendit regjistruan rritje prej 13.4 përqind.


Fondet pensionale që operojnë në Kosovë kanë strategji të ndryshme të investimit të aseteve të tyre. FKPK ndjekë një strategji të kujdesshme të investimit, duke siguruar diversifikim të rrezikut në fonde të përbashkëta investuese që menaxhohen nga ndërmarrjet për menaxhim të mjeteve. Në anën tjetër, FSKP investon asetet e tyre kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga asetet e investuara në obligacione si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit (figura 23 dhe 24).

Zgjerimi i aseteve u ndihmua nga arkëtimet e reja të cilat gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017 u shtuan për 4.0 milionë euro krahas tremujorit të njëjtë të vitit paraprak dhe arritën në 42.2 milionë euro. Nga

këto kontribute të arkëtuara, rreth 99 përqind i takojnë FKPK-së dhe pjesa e mbetur FSKP-së. Rritja e arkëtimeve u ndikua kryesisht nga numri më i madh i kontribuuesve të rinj në këtë tremujor në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, vlera e arkëtimeve të reja mund të jetë ndikuar deri në një masë edhe nga rritja e të ardhurave të të punësuarve në sektorin publik³, si sektor dominues në tregun e punës.

Në këtë tremujor FKPK arriti të realizoj një kthim nga investimet e ndërmarra prej 36.1 milionë euro, që është përmirësim i dukshëm me kthimin bruto prej 8.8 milionë të tremujorit të katërt në vitin paraprak (figura 25). Përderisa, FSKP pati një ngadalësim të kthimit bruto nga investimet duke zbritur në 179.2 mijë euro nga 257.7 mijë euro në TM4 2016.

Figura 25. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Tregjet financiare në SHBA u karakterizuan me luhatje pozitive si rezultat i lehtësirave fiskale dhe rritjes së BPV-së përtej parashikimeve. Tregu i obligacioneve qeveritare në eurozonë gjatë tremujorit të katërt u karakterizua me rënie të normave të interesit. Ky zhvillim u ndikua nga vendimi i BQE-së


për të vazhduar programin e lehtësimit sasior edhe gjatë vitit 2018 por në vlerë të reduktuar, përkundër që Eurozona përjetoi rritjen më të shpejtë ekonomike në dekadën e fundit. Megjithatë, zhvillimet pozitive në SHBA dhe strategjia investuese ndikuan në performancë të mirë të sektorit pensional, duke siguruar rritje të vlerës së kthimit në investime.

Sektori i sigurimeve

Rritja në të hyrat neto nga primet, rënia e dëmeve të ndodhura dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve rezultuan në përmirësimin e gjendjes së sektorit të sigurimeve, të karakterizuar me rezultat pozitiv financiar.

Sektori i sigurimeve u karakterizua me zhvillime pozitive gjatë TM4 2017, duke shënuar rritje të aseteve dhe duke gjeneruar fitime pas një periudhe pesë vjeçare humbesh financiare.

Figura 26. Asetet e sektorit të sigurimeve



Asetet e sektorit të sigurimeve u ndikuan kryesisht nga rritja e mjeteve likuide, saktësisht nga rritja e parave te gatshme në bankat komerciale, e që njëkohësisht përbëjnë edhe kategorinë me pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej asetet e

³ ASK, Buletini Tremujor, TM4 2017.

sektorit. Gjatë TM4 2017, asetet arritën në 4.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.3 milionë euro kundrejt TM4 2016 (figura 26).

Ecuria e gjithë sektorit përkon me atë të sigurimeve jo-jetë, të cilat edhe përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit me 87.7 përqind të gjithsej aseteve. Asetet e këtij segmenti shënuan rritje vjetore prej 6.0 milionë euro në TM4 2017 krahas TM4 2016. Ndërsa, pjesa e sigurimet 'jetë', u rritën për 2.3 milionë. Për më tepër, tremujori i katërt ishte tremujori me rritjen më të madhe vjetore të gjithsej aseteve gjatë vitit 2017.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM4 2017 arritën vlerën prej 20.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.7 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 97.1 përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara. Vlera e realizuar e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 20.2 milionë euro në TM4 2017 (10.4 përqind rritje vjetore), kurse vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë u karakterizua me rënie vjetore prej 8.4 përqind duke zbritur në 641.4 mijë euro.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), arritën në 13.6 milionë euro në TM4 2017 (11.4 milionë euro në TM4 2016), që paraqet një rritje të theksuar vjetore prej 19.4 përqind.


Pjesa e primeve të shkruara të sektorit e cila i dedikohet pagesës së dëmeve të ndodhura u zgjerua gjatë këtij tremujori për shkak të rritjes më të lartë të dëmeve të paguara gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të vogël të primeve të shkruara. Ky raport u rrit për 5.3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në 65.3 përqind (figura 27).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të këtij vitit u karakterizua me performancë pozitive dhe përmirësim të indikatorëve të profitabilitetit për dallim nga viti i kaluar.

Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve në TM4 2017 shënuan rritje vjetore prej 4.4 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, shpenzimet e sektorit të sigurimeve dhe dëmet e ndodhura u karakterizuan me një rënie të theksuar vjetore prej 14.7 përkatësisht 74.0 përqind. Si pasojë e rritjes së të hyrave kundrejt rënies së theksuar të shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura, sektori i sigurimeve në TM4 2017 regjistroi fitim prej 3.7 milionë euro, kundrejt humbjes prej 13.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia e shpenzimeve të sektorit në periudhën raportuese mund ti atribuohet deri në një masë masave të ndërmarra nga BQK në fillim të vitit 2017, konkretisht hyrjes në fuqi të Rregullores për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga

Figura 27. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



autopërgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve.

Po ashtu, rezultati pozitiv financiar u ndikua edhe nga rritja e pagesës së dëmeve nga disa kompani të sigurimit jo-jetë si dhe ndryshimit të legjislacionit sekondar të BQK-së në përputhje me kërkesat ligjore, në kuadër të Rregullores së Fondit të Kompensimit. Këto hapa kanë ndikuar në zvogëlimin e rezervave teknike, duke rezultuar në zvogëlimin e shpenzimeve dhe rrjedhimisht në realizimin e profitit.

Krahas zhvillimeve pozitive dhe përmirësimit të gjendjes së sektorit, pozicioni i likuiditetit u përmirësua gjithashtu gjatë vitit 2017. Ky përmirësim u ndikua si nga rritja e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (8.3 përqind), njëjtë edhe nga rënia e rezervave teknike (6.0 përqind) duke arritur në 104.6 përqind nga 90.7 përqind në TM4 2016. Tregues tjerë të likuiditetit po ashtu u përmirësuan ndikuar nga rënia e gjithsej detyrimeve, duke rezultuar në 91.6 përqind raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve nga 83.1 përqind në TM4 2016.

Sektori mikrofinanciar


Rritja e asetëve, kryesisht e ndikuar nga rritja e konsiderueshme e kredive të këtij sektori, si dhe rritja e të hyrave rezultuan në rritjen e vazhdueshme të këtij sektori.

Asetet

Sektori mikrofinanciar ishte një ndër sektorët me rritjen më të madhe në kuadër të sistemit financiar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017. Pjesëmarrja e

këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar mbetet e ulët në rreth 3 përqind.

Figura 28. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017, vlera e gjithsej asetëve të sektorit mikrofinanciar arriti në 10.3 milionë euro, duke shënuar rritje të theksuar prej 38.9 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (figura 28).

Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues, që u financua kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm (67.2 përqind të gjithsej asetëve).


Kreditë

Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare në TM4 2017 arriti në 9.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.5 milionë euro (figura 29).

Ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 64.1 përqind në gjithsej kredite të sektorit, u rritën për 1.1 milionë euro në krahasim me TM4 2016. Përderisa kredite ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 35.9

përqind të gjithsej kredive të sektorit, u rritën për 2.3 milionë euro.


Figura 29. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2018)

Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, nëse krahasojmë ecurinë e kreditimit të sektorëve ekonomik në tremujorët e fundit, vlen të theksohet që për të tretin vit me radhë, kreditimi i pothuajse të gjithë sektorëve ekonomik u karakterizua me rritje. Sektorët me ndryshimin më të lartë në vlerë ishin ai i 'sektorëve tjerë', pasuar nga sektori i bujqësisë (figura 30).

Figura 30. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2018)

Lizingjet

Lizingjet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017 zbritën në 0.5 milionë euro, një rënie prej 0.1 milionë euro nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak (figura 31).

Në rënien e lehtë të vlerës së lizingjeve gjatë këtij tremujori kontribuoi rënia e lizingjeve për pajisje, përderisa kategoria e 'lizingjeve tjera' (për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare) dhe lizingjet hipotekare (për ekonomitë familjare) kontribuuan në lehtësimin e rënies së tyre.

Figura 31. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi ndërruan kahje për dallim nga viti paraprak, duke shënuar rritje në të dy kategoritë dhe po thuhet për të gjithë sektorët ekonomik, rritje e cila mund të jetë reflektim i rritjes së shpenzimeve operative të institucioneve mikrofinanciare.


Gjatë këtij tremujori, norma mesatare e interesit u rrit në 22.5 përqind, nga 21.7 përqind sa ishte në TM4 2016.

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare u rrit për 0.7 pikë përqindje, ndërsa norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rritje prej 1.3 pikë përqind (figura 32). Në kuadër të ekonomive familjare norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese u zvogëluar për 0.2 pikë përqindje, përderisa për kreditë hipotekare ajo u rrit për 1.8 pikë përqindje.

Figura 33. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezulton të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, mirëpo shënoi rritje të theksuar kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak për 2.1 pikë përqind. Ndërsa, sektori i industrisë vazhdon të

ketë normën më të lartë të interesit në kredi edhe pse u zvogëluar për 0.3 pikë përqind (figura 33).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Dinamikat në sektorin mikrofinanciar mundësuan që performanca financiare pozitive të vazhdojë edhe gjatë TM4 2017. Ky sektor dyfishoi profitin në vlerë prej 1.6 milionë euro kundrejt TM4 2016 kur realizoi një profit prej 0.8 milionë euro (figura 34).


Figura 34. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të hyrave prej 8.8 milionë euro, më konkretisht atyre nga interesi prej 7.6 milionë euro, të cilat edhe përfaqësojnë rreth 85 përqind të gjithë të hyrave. Po ashtu, ndikim në rritje, por me efekt më të ulët, kishin edhe të hyrat nga jo-interesi me rritje prej 1.2 milionë euro. Rritja e të hyrave nga interesi ishte rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues nga institucionet mikrofinanciare në tre vitet e fundit, e po ashtu rezultat i rritjes së normës së interesit të aplikuar për kredi. Njëkohësisht, rritja e të hyrave nga jo-interesi i atribuohet arketimeve nga të ardhurat tjera operative. Gjithë shpenzimet e

sektorit po ashtu shënuan rritje vjetore prej 7.2 milionë euro, prej të cilave rritjen më të madhe e patën shpenzimet nga jo-interesi e veçanërisht shpenzimet e personelit dhe ato administrative.

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit të katërt dhe gjatë gjithë vitit 2017, treguesit e profitabilitetit të kalkuluar për gjithë vitin shënuan përmirësim të ndjeshëm (figura 35).



Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të mirë me provizione.




Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë deri në dhjetor 2017 u zvogëlua për 0.4 pikë përqindje kundrejt vitit paraprak duke rënë në 2.5 përqind (figura 36). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2017 qëndroi në nivel prej 190.3 përqind krahasuar me nivelin prej 200.2 përqind në dhjetor 2016.

Tregu i letrave me vlerë

Në TM4 2017, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës realizoi 5 ankande, në të cilat u emetuan bono dhe fletë-obligacione qeveritare në vlerë prej 104.95 milionë euro (figura 37).


Figura 37. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Vlera e emetuar në këtë tremujor ishte për 23.5 përqind më e lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak dhe për 31.2 përqind më e lartë se në tremujorin paraprak të këtij viti. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri i ankandëve dhe shuma e arkëtuar nga emetimi i bonove të thesari në këto ankande u zvogëlua, përderisa numri dhe shuma e arkëtuar nga emetimi i fletë-obligacioneve u rrit (tabela 2).

Fillimi i emetimit të fletë-obligacioneve qeveritare me afat maturimi prej 7 viteve ka ndikuar që norma mesatare e interesit në këto letra me vlerë të jetë më e lartë dhe afati mesatar i maturimit të portfolios së letrave me vlerë të jetë më i gjatë (figura 38).

Figura 38. Shuma e kërkuar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Norma mesatare e interesit në bono të thesarit të emetuara gjatë TM4 2017 ishte 0.3 përqind (0.2 përqind në TM4 2016), ndërsa fletëobligacionet qeveritare këtë tremujor u emetuan me normë mesatare prej 1.6 përqind krahasuar me normën 0.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Tabela 2. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës

Periudha	Bono të thesarit		Fletëobligacionet	
	Numri i realizuar	Shuma e pranuar	Numri i realizuar	Shuma e pranuar
TM4 2012	3	30.00	-	-
TM4 2013	5	70.20	-	-
TM4 2014	4	79.85	1	15.00
TM4 2015	3	65.00	2	35.00
TM4 2016	3	65.00	1	20.00
TM4 2017	2	49.95	3	55.00


Burimi: Ministria e Financave (2018)

Përderisa në tremujorin e katërt të vitit paraprak afati mesatar i maturimit në letrat me vlerë të emetuara ishte përafërsisht 1.2 vite, në tremujorin e

katërt të këtij viti afati mesatar u zgjerua në afërsisht 2.7 vite.

Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit u kategorizua në bono thesari me afat maturimi 182 ditë, 364 ditë dhe fletë-obligacione 2 vite, me pjesëmarrje të njëjtë prej 23.8 përqind. Kurse, fletë-obligacioni me afat maturimi 7 vite, që për herë të parë u emetua në gusht të këtij viti, shënoi pjesëmarrje prej 9.5 përqind të gjithë shumës së emetuar në TM4 2017 (figura 39).

Figura 39. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Shuma e kërkuar nga pjesëmarrësit ishte për 1.6 herë më e lartë se shuma e emetuar në ankande nga Ministria e Financave (1.9 herë më e lartë në TM4 2016). Përkundër raportit më të ulët kërkesë-ofertë, në këtë tremujor kërkesa për të investuar në letra me vlerë ishte për 2.2 përqind më e lartë (figura 39). Rrjedhimisht kërkesa më e lartë si dhe emetimi i instrumenteve me afat më të gjatë maturimi rezultoi që norma e përgjithshme mesatare e interesit të jetë më e lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (figura 39). Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës përbëjnë instrumente atraktive për investim

konsideruar rrezikun zero që bartin. Prandaj bankat në këtë rast sipas rregulloreve në fuçi mbi adekuatshmërinë e kapitalin, nuk kanë nevojë të mbajnë rezerva të kapitalit për këtë kategori të aseteve me peshë rreziku zero.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 21, TM4 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor, TM4 2017: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/buletini-tremujor-tm4-2017>
- g)

Të tjera (2018):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2017): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2016	2017
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	6,070.1	6,282.2
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.3%	1.5%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.3%	0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,596.5	1,681.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,657.6	1,740.5
Bilanci primar (në milionë euro)	-61.1	-59.0
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,386.9	5,917.1
prej të cilave: Bankat	3,637.1	3,877.5
Kredi	2,230.0	2,485.3
Depozita	2,897.8	3,092.5
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.2%	6.8%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.2%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	6.0%	5.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-467.2	-425.1
prej të cilave: remitencat e pranuar	691.0	759.2
Llogaria financiare	-199.1	-330.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	220.0	287.8
Investimet portfolio, net	343.6	14.7
Investimet tjera, net	-264.0	-164.7
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-81.0	-120.1
Asetet	4,547.7	4,824.4
Detyrimet	4,628.7	4,944.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,015.1	2,091.6
Borxhi i jashtëm privat	1,570.5	1,598.3
Borxhi i jashtëm publik	444.6	493.3

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

